



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 3134 prot.

Tiranë, më 02.11.2020

VENDIM


Nr. 41, datë 21.10.2020

“Për fillimin e procedurave të vetëkandidimit për anëtarë të Komisioneve të Përhershme në nivel institucional dhe të Këshillit të Etikës”

Bazuar në ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 36, pika 7 dhe neni 38; në Statutin e Universitetit të Tiranës, nenet 37, 38, 39, 40, 41, 42 dhe 43, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e datës 21.10.2020,

VENDOSI:

1. Të miratojë fillimin e procedurave të vetëkandidimit për anëtarë të Komisioneve të Përhershme në nivel institucional dhe të Këshillit të Etikës, si më poshtë:
 - A. Komisioni i promovimit të personelit akademik;
 - B. Komisioni i mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët;
 - C. Komisioni i përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë;
 - Ç. Komisioni i përhershëm i kurrikulës;
 - D. Këshilli i etikës.
2. Vendimi i përcillet për zbatim të gjitha njësive përbërëse të Universitetit të Tiranës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



KRYETARI

Prof. Dr. Artan Hoxha